



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi</i>	<i>Data e autorizimit të ekspertit</i>	<i>Data e dorëzimit të raportit</i>	<i>Nr. i lëndës</i>
<i>Gjemajli Bellanica;</i>	30.05.2022	09.06.2022	165/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.05.2022 OE “**Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni-Bablak**” Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr. 165/22 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetit e prokurimit me titull: “**Mbarësimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëti të imëta kundër sëmundjeve elostriidiale**”, me nr. të prokurimit: **656-22-2298-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK – Ferizaj**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë me një Operator Ekonomik, procedurë të hapur, Shërbim, vlera e parashkuar e kontratës: 190.000.00 €

Data e njoftimit për kontratë.....	24.03.2022.
Hapja e ofertave.....	04.05.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....	12.05.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	17.05.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....	18.05.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

*Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni-Bablak**” Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mbarësimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëti të imëta kundër sëmundjeve elostriidiale**”, me nr. të prokurimit: 656-22-2298-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Ferizaj**.*

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE “Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni-Bablak” Ferizaj

Dispozitat e shkelura

Neni 1 - Qëllimi
 Neni 5 - Kalkulimi i afateve kohore
 Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
 Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
 Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
 Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
 Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
 Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Pretendimi 1 (LPP/Neni 1:Qëllimi): Autoriteti kontraktues shkel te 3 paragrafet e nenit 1 te ligjit per prokurim publik. Perderisa paragrafi 1 thot: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.* Autoriteti kontraktues ka bere shkeljen e ketij neni ne pergjigthesi duke e anuluar aktivitetin e prokurimit pa asnje rasye valide. Arsyeja e anulimit sipas AK eshte mospermbushja e kapaciteteve teknike profesionale, pa e detajuar. Ndersa oferta jone eshte oferte voluminoze. Ne jemi pergaditur per kete aktivitet duke bere konzorcium me partner serioz ne menyre qe ti permbushin sakt kerkesat e dosjes tenderike. Autoriteti Kontraktues ka lene hapjen e ofertave per nje tender kaq te rendesishem ne nje dite feste, pra afati per dorezimin e ofertave 03.05.2022 ora 13:00 DITE PUSHIMI ndersa hapja eshte bere me daten 04.05.2022. Pra AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-se duke i diskriminuar operatoret ekonomik duke u pamundesuar te ofertojn ne nje dite feste.

Pretendimi 2 (LPP/Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore) – Paragrafi i dyte i ketij neni thote: “Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.” Pra AK ka bere shkelje te ketij paragrafi dhe te nenit ne pergjigthesi kur ka lene si afat te hapjes daten 03.05.2022 e cila ka qen nje dite feste pra dite pushimi. Pra afati per dorezimin e ofertave 03.05.2022 ora 13:00 DITE PUSHIMI ndersa hapja eshte bere me daten 04.05.2022.

Pretendimi 3 (LPP/Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) - Paragrafi i pare i nenit 6 te Ligjit te prokurimit publik thote: Te gjitha autoiritete kontraktuese jane te obliguara qe te sigurojn qe fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne mneyren me ekonomike, njekohesisht duke marre ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit. Autoriteti kontraktues bene shkelje te ketij neni me rastin e eliminimit tone nga gara edhe pse oferta jone eshte ne perputhje te plote me kerkesat e dosjes tenderikesi si dhe eshte oferta me e lire. Autoriteti kontraktues ka bere shkeljen e ketij neni ne pergjigthesi duke e anuluar aktivitetin e prokurimit pa asnje rasye valide. Arsyeja e anulimit sipas AK eshte mospermbushja e kapaciteteve teknike profesionale, pa e detajuar. Ndersa oferta jone eshte oferte voluminoze. Ne jemi pergaditur per kete aktivitet duke bere konzorcium me partner serioz ne menyre qe ti permbushin sakt kerkesat e dosjes tenderike. Autoriteti Kontraktues ka lene hapjen e ofertave per nje tender kaq te rendesishem ne nje dite feste, pra afati per dorezimin e ofertave 03.05.2022 ora 13:00 DITE PUSHIMI ndersa hapja eshte bere me daten 04.05.2022. Pra AK ka bere shkelje te nenit 6 te LPP-se duke i diskriminuar operatoret ekonomik duke u pamundesuar te ofertojn ne nje dite feste.

Pretendimi 4 (LPP/Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi):Paragrafi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Me kete rast Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij paragrafi dhe

te Nenit 7 te LPP_se ne pergjithesi pasi qe Autoritreti Kontraktues ka bere shkeljen e ketij neni ne pergjigthesi duke e anuluar aktivitetin e prokurimit pa asnje rasye valide. Arsyeja e anulimit sipas AK eshte mospermbushja e kapaciteteve teknike profesionale, pa e detajuar. Ndersa oferta jone eshte oferte voluminoze. Ne jemi pergaditur per kete aktivitet duke bere konzorcium me partner serioz ne menyre qe ti permbushin sakt kerkesat e dosjes tenderike. Autoriteti Kontraktues ka lene hapjen e ofertave per nje tender kaq te rendesishem ne nje dite feste, pra afati per dorezimin e ofertave 03.05.2022 ora 13:00 DITE PUSHIMI ndersa hapja eshte bere me daten 04.05.2022. Duke pas parasysh se ne dite feste nuk eshte punuar as nga kompanit e sigurimit, ne eshte dashur qe te endemi neper Kosove per te gjetur nje vullnetar per te bere te mundshem sigurimin per oferte si dokument esencial i ofertes. Pa dyshim kjo eshte edhe arsyeja pse per kete tender jane vetem 2 oferta. Pra AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-se duke i diskriminuar operatoret ekonomik duke u pamundesuar te ofertojn ne nje dite feste.

Pretendimi 5 (LPP/Neni 59 i LPP-së- Egzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve) - Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik duke e hedhur posht oferten tone. Vetem shikojeni arsyejen e anulimit se ne si konzorcium nuk i kemi plotesuar kerkesat teknike

permisuar kerkesat teknike/profesional te saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontraktimit.

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

Si Grup i Operatorëve Ekonomik nuk i keni plotësuar kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional, ashtu siç janë kërkuar në Dosjen e tenderit.

Rezultatet e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të

Pra autoriteti kontraktues e hedh poshte oferten tone pa bere hiq proces te vleresimit.

Pretendimi 6 (LPP/Neni 69: Aftesit teknike dhe profesionale): Autoriteti kontraktue ka bere shkelje te ketij nenit me rastin e eliminimit te operatorit ton edhe pse oferta jone eshte ne perputhje te plote me kerkesat e dosjes tenderike. Vetem shikojeni arsyejen e anulimit se ne si konzorcium nuk i kemi plotesuar kerkesat teknike profesionale pa e specifikuar se ne cillen pike nuk i kemi plotesuar.

permisuar kerkesat teknike/profesional te saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontraktimit.

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

Si Grup i Operatorëve Ekonomik nuk i keni plotësuar kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional, ashtu siç janë kërkuar në Dosjen e tenderit.

Rezultatet e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të

Pra autoriteti kontraktues e hedh poshte oferten tone pa bere hiq proces te vleresimit.

Pretendimi 7 (LPP/Neni 72: Dokumentacioni dhe informacioni shtese): Autoriteti kontraktue ka bere shkelje te ketij nenit me rastin e eliminimit te operatorit ton pa kerkuar sqarime per oferten tone. Vetem shikojeni arsyejen e anulimit se ne si konzorcium nuk i kemi plotesuar kerkesat teknike profesionale pa e specifikuar se ne cillen pike nuk i kemi plotesuar.

perimousim... teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe ne njohimim e...

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

Si Grup i Operatorëve Ekonomik nuk i keni plotësuar kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional, ashtu siç janë kërkuar në Dosjen e tenderit.

...proullat e zhatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të
...Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe
Pra autoriteti kontraktues e hedh poshte oferten tone pa bere hiq proces te vleresimit.

Pretendimi 8 (LPP/ Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve): Autoriteti kontraktue ka bere shkelje te nenit 108/A me rastin e rishqyrtimit te kerkeses ton. Ne njoftimit per eliminim AK e shkruan se ne nuk i plotesojm kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional pa e specifikuar cillat kerkesa jane ato, ndersa ne vendimin per kerkesen per rishqyrtim thot "*Lejen nga AUV për përdorimin e materialit gjenetik në teritorin e Republikës së Kosoves (kopje e noterizuar). Kurse ju keni ofruar vetem lejen per import te materialit gjenetik ku edhe kjo leje eshte me afate te skaduar*". Ne si operator ekonomik e kemi bashkangjitur origjinalin e lejes per materjale gjenetik (bashkangjitur dokumenti 7). Leja e importit te materjalit gjenetik e ka kuptimine edhe te perdorimit ne Republiken e Kosoves. Ne si operator ekonomik e kemi licencen e AUV per ushtrimin e veprimtarise ne territorin e Republikes se Kosoves edhe licencen per importin e materjalit gjenetik. Prandaj autoriteti kontraktues eshte dashur te kerkoj sqarime duke u bazuar ne nenin 72 te LPP-se. Tek kerkesa kopje e noterizuar ne e kemi bashkangjitur origjinalin dhe jo kopjen. Gjithashtu tek arsyetimi i dyte i autoritetit kontraktues "*2- Materiali gjenetik i racave që do të përdoren për mbarsim artificial duhet të dëshmohej përmes katalogut të këtyre racave:1. Simental qumësht-mish, 2. Simental-mish , 3. Holstain , 4. Limousin 5. Charolei, 6. Blue Belgian, 7. Montbiliard - Materiali gjenetik i përdorur duke u bazuar në standardet e fertilitetit të fares së demave duhet të ketë TMI GZW mbi 120 ku kerkesa ka qene qe te deshmohej me katalog. Kurse katalogun te cilen ju e keni ofruar nuk i ka plotesuar keto standarde*". Ne i kemi bashkangjitur katalogun sakt sipas kerkesave te AK (dokumenti 8).

AK ne vend qe te kerkoj sqarime ne baze te nenit 72, AK na eliminon me arsyet shabllon se nuk i plotesojm kerkesat teknike profesionale.

Duke pare shkeljet e dispozitave te Ligjit per Prokurim Publike dhe Rregullores dhe Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik nga komisioni i vleresimit, at'here kerkojm nga Organi Shqyrtues i Prokurimit t'a kthej kete procedure te prokurimit ne procesin e Ri-vleresimit. Ne procesin e rivleresimit te behet vleresimi real i ofertes son dhe duke pare aftesit tona profesionale dhe kapacitetet teknike si dhe eksperiencen tone ne kete lemi, te shpallemi fitues i ksaj kontrate.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit

2. Çertifikata e TVSH-së,

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

N/A

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, shërbime, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 280,000.00 €

Licencën apo vendimin për ushtrimin e veprimtarisë veterinarë nga AUV.

Lejen nga AUV për përdorimin e materialit gjenetik në territorin e Republikës së Kosovës.

Materiali gjenetik i racave që do të përdoren për mbarsim artificial duhet të dëshmohet përmes katalogut të

këtyre racave 1. Simental qumësht-mish 2. Simental-mish 3. Holstain 4. Limousin

5. Charolei 6. Blue belgian 7. Montbiliard -Materiali gjenetik i përdorur duke u bazuar në

standardet e fertilitetit të farës së demave duhet të ketë TMI GZW mbi 120.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

1. Kopje- Çertifikata e Biznesit për veprimtari adekuate

2. Kopje- Çertifikata e TVSH

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

N/A

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë listën e kontratave të nënshkruar dhe të vëlosur në origjinal. Në listë duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.

Licencën apo vendimin për ushtrimin e veprimtarisë veterinarë nga AUV (kopje e noterizuar).

Lejen nga AUV për përdorimin e materialit gjenetik në territorin e Republikës së Kosovës (kopje e noterizuar).

Te dëshmohet me katalog.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komuna Ferizaj - Zyra e Prokurimit

anulon procedurën e Prokurimit

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE “Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni-Bablak” Ferizaj

Sqarim,

Autoriteti Kontraktues në njoftimin për kontratë të dt.24.03.2022 ka përcaktuar dt. 03.05.2022 si datë e hapjes së ofertës ndërsa data e njëjtë ka qenë ditë feste dhe hapja e ofertave është bërë në ditën pasuese me datën 04.05.2022. Kjo është paraparë edhe në nenin 5 paragrafi 2 i LPP-së.

Autoriteti kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit pa u mbështetur në asnjë dispozitë ligjore si dhe pa dhënë ndonjë arsyetim konkret në letrën standarde vetëm duke u thirrë në atë se: “ si GOE nuk i keni plotësuar kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit”.

Ndërsa në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim AK-ja ka dhënë arsyetim lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues, dhe këtë përgjigje AK-ja është dashur t’ia paraqesë operatorëve ekonomik në letër standarde.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë se AK-ja ka bërë shkelje të nenit 108/A me rastin e shqyrtimit të kërkesës tonë për rishqyrtim. Në vendimin e kërkesës për rishqyrtim thotë: Leja nga AUV për përdorimin e materialit gjenetik në territorin e Republikës së Kosovës (kopja e noterizuar), kurse ju keni ofruar lejen vetëm për import të materialit gjenetik ku edhe kjo leje është me afat të skaduar. Ne si OE kemi bashkangjitur origjinalin e lejes për material gjenetik. Leja e importit të materialit gjenetik e ka kuptimin edhe të përdorimit në Republikën e Kosovës.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“Lejen nga AUV për përdorimin e materialit gjenetik në territorin e Republikës së Kosovës”*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Lejen nga AUV për përdorimin e materialit gjenetik në territorin e Republikës së Kosovës (kopje e noterizuar)”*

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dokumentet e ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit thekson se OE ankues ka prezantuar dëshminë “LEJE IMPORTI”, e cili është me afat të skaduar dhe e pa noterizuar ndërsa kërkesë ka qenë të jetë e noterizuar. Nga emërtimi i dëshmisë së prezantuar dhe kërkesës së AK-së, kjo dëshmi nuk rezulton të jetë e njëjtë për nga emërtimi, pra është kërkuar *“Lejen nga AUV për përdorimin e materialit gjenetik në territorin e Republikës së Kosovës (kopje e noterizuar)”*, ndërsa është ofruar “LEJE IMPORTI”. Andaj, eksperti shqyrtues mendon se pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Gjithashtu edhe arsyeja e dytë e AK-së “materiali gjenetik i racave që do të përdoret për mbarsim artificial duhet të dëshmohet përmes katalogut të këtyre racave..... Materiali gjenetik i përdorur duke u bazuar në standardet e fertilitetit të farës së demave duhet të ketë TMI GZW mbi 120 ku kërkesë ka qenë që të dëshmohet me katalog, kurse katalogu te cilin ju e keni ofruar nuk i ka plotësuar këto standarde.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“Materiali gjenetik i racave që do të përdoren për mbarsim artificial duhet të dëshmohet përmes katalogut të këtyre racave*
1. Simental qumësht-mish 2. Simental-mish 3. Holstain 4. Limousin 5. Charolei 6. Blue belgian 7. Montbiliard - Materiali gjenetik i përdorur duke u bazuar në standardet e fertilitetit të farës së demave duhet të ketë TMI GZË mbi 120”.

Ndërsa dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Te dëshmohet me katalog”*

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues si dëshmi ka prezantuar katalogun e kërkuar në FDT, mirëpo standardet e fertilitetit të farës së Demave nuk janë ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtim të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizë konkrete të dokumentacionit të lëndës. Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pa bazuar duke sugjeruar që aktivitetin e prokurimit me titull **“Mbarësimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta kundër sëmundjeve elostriale”** të anulohet.

Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i shtjellimeve të pretendimeve ankimore dhe duke u mbështetur në nenin 44.5 pika (ii) të RRUOPP ku asnjëri prej tenderëve nuk është i përgjegjshëm.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “**Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni - Bablak**” Ferizaj, të refuzohet si e pa bazuara, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Raporti i ekspertizës t’i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - KK - Ferizaj

Panelit Shqyrtues - OSHP

OE ankues -OE “Ambulanca dhe Farmacia Veterinare Goni - Bablak” Ferizaj